

Raport individual për rezultatin e konsultimit publik për projektligjin “Për një shtesë në ligjin nr. 10 247, datë 4.3.2010, “Për kornizën shqiptare të kualifikimeve”, i ndryshuar”

1. Titulli i projektligjit

Projektligji “Për një shtesë në ligjin nr. 10 247, datë 4.3.2010, “Për kornizën shqiptare të kualifikimeve”, i ndryshuar.

2. Kohëzgjatja e konsultimeve

Konsultimi paraprak i këtij dokumenti ka nisur brenda institucionit që në fazën e hartimit të draftit fillestar dhe komentet/sugjerimet janë finalizuar në versionin e parë të këtij dokumenti.

Dokumenti u publikua në RENJK në adresën “konsultimipublik.gov.al”, në datën 28.09.2023 për marrjen e komenteve dhe rekomandimeve nga qytetarët dhe shoqëria civile, deri në datën 26.10.2023, duke respektuar afatin prej 20 ditë pune.

3. Metoda e konsultimit

Metodat e konsultimit të përdorura për Projektligjin “Për një shtesë në ligjin nr. 10 247, datë 4.3.2010, “Për kornizën shqiptare të kualifikimeve”, i ndryshuar”, janë si më poshtë vijon:

Publikimi në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike në link-un: <https://konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/660>

Nëpërmjet adresës së e-mailit:

Projektligji është publikuar në faqen zyrtare të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit (<https://arsimi.gov.al/per-nje-shtese-ne-ligjin-nr-10-247-date-4-3-2010-per-kornizen-shqiptare-te-kualifikimeve-i-ndryshuar/>), duke mirëpritur sugjerime në rubrikën e dedikuar për konsultimin publik.

Nëpërmjet adresës postare:

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 23, AL 1001, Tiranë. E-mail: info@arsimi.gov.al. Çdo palë e interesuar pati mundësinë të dërgojë në formë shkresore, në adresë të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit të gjitha komentet/sugjerimet mbi përmbajtjen e projektligjit.

4. Palët e interesit të përfshira

“Për një shtesë në ligjin nr. 10 247, datë 4.3.2010, “Për kornizën shqiptare të kualifikimeve”, i ndryshuar” u publikua për konsultim në RENJK. Kontribut kanë dhënë gjatë procesit të konsultimit grupet e interesit, por dhe aktorë të tjerë në nivel qendror si ministrinë e linjës. Ky projektakt nuk është vijuar më tej duke qenë se u propozua në vijim të negociimit të marrëveshjes së njohjes së diplomave të arsimit të lartë, me shtetin grek i cili nuk ka përcjellë përgjigje për të vijuar negociatat.

Procesi i konsultimit nuk është shoqëruar me komente pas publikimit në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike.